L I G J
Nr.9519, datë 18.4.2006

PËR NJË SHTESË DHE NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8464, DATË 11.3.1999 "PËR STANDARDIZIMIN", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin", të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në fund të nenit 7 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit kontrollohet nga Bordi Drejtues. Kriteret e përfaqësimit, numri i anëtarëve dhe rregullorja e funksionimit të Bordit Drejtues përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 2

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 8

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit është institucion qendror publik, me qendër në Tiranë, në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit është institucion buxhetor, me buxhet më vete.
Drejtori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4861, datë 10.5.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu